



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 81, Datë 15.03.2023

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” SH.P.K. PËR  
MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR BARRËSIMIN E LLOGARIVE  
BANKARE DHE CASH SI MJET PËR GARANTIMIN E PËRMBUSHJES SË  
DETYRIMIT NDAJ “RAIFFEISEN BANK” SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 3 dhe nenit 8 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollojnë interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollojnë interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 914/1 prot., datë 13.03.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e të licencuarve “SUN BEAT SYSTEM” sh.p.k., “TREN SUN SYSTEM” sh.p.k., “ERNI SOLAR” sh.p.k., “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. dhe “NTSP” sh.p.k., për marrjen e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të kapitalit të tyre si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 918 prot, datë 21.02.2023, ka paraqitur kërkesën për marrjen e autorizimit për barrësimin e llogarive bankare dhe CASH si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a.
- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 191, datë 21.07.2022.

- *Marrëveshja e Barrës Siguruese nr. 984 rep, nr. 733 kol., datë 02.03.2022*, nënshkruar me Raiffeisen Bank sh.a. (në cilësinë e barrëmarrësit), e depozituar nga shoqëria në kuadër të marrjes së autorizimit, ku vendoset barrë siguruese mbi llogaritë bankare dhe CASH që shoqëria “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k., ka ose do të ketë pranë kësaj banke, është nënshkruar përpara se shoqëria të licencohej nga ERE në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- Për sa më sipër, ERE nuk mund të marrë në shqyrtim këtë kërkesë, për marrje autorizimi për barrësim të të ardhurave të një të licencuari, sa kohë kjo nuk është parashikuar në kompetencat e ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Të mos marrë në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “KORÇA PHOTOVOLTAIC PARK” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për barrësim të të ardhurave si mjet për garantimin e detyrimeve ndaj “RAIFFEISEN BANK” sh.a.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**